

## 12.2 HAPËSIRA E PUNËS

Është pjesë e dritares së shfletuesit, ku ngarkohen regjistrimet bibliografike dhe ato të njësuara, të cilat janë krijuar, redaktuar ose përzgjedhur pas kërkimit. Hapësira e punës është vendi, ku mund të punohet më tej me këto regjistrime.

Para të dhënave identifikuese të regjistrimit qëndron ikona, që tregon llojin e regjistrimit, siç është "Bl" – Regjistrimi bibliografik nga baza lokale e të dhënave, "Bv" – Regjistrimi bibliografik nga baza e të dhënave COBIB, "Cn" – Regjistrimi i njësuar nga baza e të dhënave CONOR, "Cs" – Regjistrimi i njësuar nga baza e të dhënave SGC "Cr" – Regjistrimi nga baza e të dhënave CORES, "Ab" – Regjistrimi bibliografik arkivor dhe "An" – Regjistrimi i njësuar arkivor.

---

### 12.2.1 Ngarkimi i regjistrimeve

Kur programi COBISS3 hapet, hapësira e punës është e zbrazët. Ndërkohë në hapësirën e punës ngarkohen regjistrimet, të cilat janë:

- krijuar
- redaktuar
- përzgjedhur mes rezultateve të kërkimit, nëse dritaren e kërkimit e keni hapur në shfletues
- përzgjedhur mes objekteve të lidhura
- përzgjedhur mes shkurtimeve

Çdo regjistrim i shtuar në hapësirën e punës sistemohet në fund të listës së regjistrimeve të ngarkuara. Nëse regjistrimi ndodhet në hapësirën e punës, ai nuk ngarkohet përsëri, por vetëm selektohet. Nëse regjistrimi është përzgjedhur për t'u fshirë (001a = "d") ose për t'u ndarë (001a = "r"), ai shfaqet me ngjyrë hiri. Me ngjyrë hiri shfaqen edhe regjistrimet e njësuara nga baza e të dhënave SGC, që janë në përgatitje e sipër.

---

### 12.2.2 Përzgjedhja e regjistrimeve

Në hapësirën e punës ju mund të përzgjedhni regjistrimet për procedurat e mëtejshme. Regjistrimin e veçantë e përzgjidhni duke klikuar ikonën ose të dhënat identifikuese nga regjistrimi. Regjistrimi i përzgjedhur selektohet. Në nëndritaren **Atributet e klasave** shfaqen atributet e regjistrimit të përzgjedhur dhe vlerat e tij, ndërsa në nëndritaren **Objektet e lidhura** shfaqen regjistrimet të cilat janë të lidhura me regjistrimin e përzgjedhur.

Pas përzgjedhjes së regjistrimit në hapësirën e punës mund të përdorni këto metoda:

- metodën **Objekti / Redakto** për ngarkimin e regjistrimit në kujtesën e

fragmenteve të regjistrimeve në ndërfaqen për katalogim (në vend të metodës mund të klikoni dy herë në regjistrim)

- metodën **Objekti / Shfaq** për kontrollimin e regjistrimit, përkatësisht regjistrimit i cili është i lidhur me të
- metodën **Objekti / Shto në shkurtore** për shtimin e regjistrimit të shkurtoret (shih kap. 12.5.1)
- metodën **Objekti / Largo objektin e përzgjedhur** për largimin e regjistrimit nga hapësira e punës (shih manualin *Udhëzime themelore COBISS3*)
- metodën **Objekti / Printo** për dërgimin e regjistrimit në destinacionin e paracaktuar (printer) (shih manualin *Udhëzime themelore COBISS3*)
- metodën **Objekti / Dërgo** për dërgimin e regjistrimit në destinacionin e paracaktuar (printer ose adresë elektronike) (shih manualin *Udhëzime themelore COBISS3*)
- metodën **Objekti / Shto në radhën e raportit** për shtimin e regjistrimit në radhën e raportit (shih manualin *Udhëzime themelore COBISS3*)
- metodën **Objekti / Verifiko regjistrimin** për të verifikuar, nëse regjistrimi ka gabime (të verifikueshme në mënyrë automatike) (shih kap. 6.4 dhe kap. 7.1.7)
- metodën **Objekti / Krahaso regjistrimin** për krahasimin e regjistrimeve (shih kap. 6.5)
- metodën **Objekti / Shfaq variantin e regjistrimit nga baza lokale e të dhënave** për shtimin e regjistrimit përkatës nga baza lokale e të dhënave (shih kap. 6.2.2.2)
- metodën **Objekti / Shfaq variantin e regjistrimit nga COBIB-i** për shtimin e regjistrimit përkatës nga COBIB-i (shih kap. 6.2.2.1)
- metodën **Objekti / Përgatit regjistrimet për printim** për printimin e disa regjistrimeve njëherësh (shih kap. 12.1.5)
- metodën **Objekti / Shfaq listën e bibliotekave** për shfaqjen e listës së bazave lokale të të dhënave dhe gjendjen e koleksioneve (shih kap. 6.7.5)
- metoda **Objekti / Verifiko dublikatat** për të verifikuar nëse regjistrimi i përzgjedhur është dublikatë e regjistrimit ose regjistrimeve ekzistuese në COBIB (shih kap. 6.7.6)
- metodën **Objekti / Shto përmbajtjen digjitale në dCOBISS** për shtimin e përmbajtjeve digjitale (p.sh. fotografi, audio, skedarë në PDF etj.) në regjistrimin bibliografik (shih manualin *COBISS3/Koleksionet e bibliotekës*, kap. 16)
- metoda **Objekti / Shfaqja nga arkivi** për shfaqjen e listës së varianteve arkivore të regjistrimit (shih kap. 6.7.7)

Pas përzgjedhjes së regjistrimit në hapësirën e punës, përveç metodave, të cilat janë të përbashkëta për regjistrimet bibliografike dhe ato të njësuara, mund të përdoren edhe këto metoda vetëm për regjistrimet e njësuara:

- metodën **Objekti / Merr përgjegjësinë për regjistrimin** për marrjen e përgjegjësisë për të dhënat në regjistrimin e njësuar (shih kap. 9.4.1) – metoda është e disponueshme vetëm te regjistrimet e njësuara nga baza e të dhënave CONOR
- metodën **Objekti / Anulo përgjegjësinë për regjistrimin** për anulimin e përgjegjësisë për regjistrimin e njësuar (shih kap. 9.4.2 dhe kap. 10.4.1)
- metodën **Objekti / Lidh me regjistrimet bibliografike** për lidhjen në paketë të regjistrimeve të njësuara me ato bibliografike (shih kap. 9.4.3 dhe kap. 10.4.5)
- metodën **Objekti / Regjistrimet e lidhura bibliografike** për kërkimin dhe shfaqjen e regjistrimeve bibliografike, të cilat janë të lidhura me regjistrimin e njësuar (shih kap. 9.4.4 dhe kap. 10.4.2)
- metodën **Objekti / Procedurat e redaktimit** për verifikimin e regjistrimeve të njësuara nga baza e të dhënave SGC – metoda është e disponueshme vetëm te regjistrimet e njësuara nga baza e të dhënave SGC



Këshillë:

Metodat nga menuja **Objekti** mund të përzgjidhen edhe nga menuja e kontekstit.